

## **Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat**

### **Shpall funksionin e lirë për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.**

Në mbështetje të neneve 3 pika a, 21 dhe 76 e vijues dhe 86 të Ligjit Nr.70/2014” Për Shërbimin Për Çështjet e Brendshme Dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe bazuar në Urdhrin Nr. 579, datë 26.10.2018, “Mbi miratimin e Strukturës dhe Organikës të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” si dhe neneve 107, 108 e vijues të Rregullores së Shërbimit Për Çështjet e Brendshme Dhe Ankesat, miratuar me Vendim Nr.829 , datë 03.12.2014 , të Këshillit të Ministrave.

1. Shpalljen e funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si më poshtë:
  - 2 (dy) funksione organike, Drejtor Drejtorie në Drejtoritë Rajonale të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Drejtues / Drejtues i Parë).
  - 3 (tre) funksione organike, Shef Sektori Hetimi në Drejtoritë Rajonale të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Kryeinspektor / Drejtues).
  - 4 (katër) funksione organike, Specialist Hetimi në Drejtoritë Rajonale të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Inspektor / Inspektor i Parë) .
  - 2 (dy) funksione organike, Specialist në Drejtoritë Qendër të SH.Ç.B.A-së, me gradën e Shërbimit (Kryeinspektor)
2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të nenit 76 të ligjit 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta të parashikuara nga ligji 70/2017 dhe ndër të tjera:
  - a. Arsimi i lartë Policor ose “Master i Shkencave” në Drejtësi.
  - b. Punonjësit para se të pranohen në Shërbim, në strukturat hetimore e operacionale, duhet të kenë përvojë pune jo më pak se 3 (tre) vjet dhe vlerësime të larta në punë, në këto struktura të shërbimeve:
    1. hetimit të Prokurorisë;
    2. hetimit të krimit të Policisë së Shtetit;
    3. me kompetenca të Policisë gjyqësore;
    4. informative të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe/ose Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
    5. inspektimit të Shërbimit, pasi të kenë kryer trajnimin përkatës për vendin e punës.
  - c. Të ketë njohuri të mira gjuhës së huaj, preferohen gjuhët e BE-së.

- d. Të mos jetë marrë masa disiplinore e përjashtimit nga detyra shtetërore gjatë shtatë viteve të fundit .
- e. Të mos ketë marrë asnjë masë disiplinore gjatë vitit të fundit.
- f. Të njohë dhe përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
- g. Të ketë aftësi të mira komunikuese në të folur e të shkruar.
- h. Të jetë i gatshëm të caktohet me shërbim kudo, sipas strukturës së Shërbimit brenda territorit të vendit.

**4. Periudha e aplikimit fillon me datë 17.04.2019 dhe përfundon më datë 26.04.2019.**

1.